

KLSH MERR PJESË NË TAKIMIN E XV TË GRUPIT TË PUNËS SË IT TË ORGANIZATËS EVROPIANE TË INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT DHE NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE “GJYKATA RUMUNE E LLOGARIVE - 30 VJET PROGRES DREJT DIXHITALIZIMIT TË AUDITIMIT”



Në datat 6-8 Shtator , u zhvillua takimi i XV i grupit të punës së IT të EUROSAT-t dhe disa aktivitete me rastin e 30-vjetorit të Gjykatës Rumune të Llogarive në Bukuresht, Rumania

Organizues të këtij takimi ishin Zyra Kombëtare e Auditimit të Estonisë në cilësinë e kryesuesit të këtij grupi pune, si dhe Gjykata e Llogarive të Rumanisë dhe përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga e gjithë bota.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, si një nga 41 anëtarët aktivë të këtij grupi pune, u përfaqësua në këto evente nga z. Aldo Kita, Drejtor i Drejtorisë së shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe z.Rodjan Alimerkaj,

Punimet e ditës së parë të takimit trajtuan tematikën lidhur me "Standardet dhe udhëzimet e IT - Cila është e ardhmja e auditimit të IT" me prezantime nga përfaqësuesit e SAI-ve të Indisë, Gjermanisë, Turqisë dhe Azerbajxhanit ku u paraqitën eksperiencat e këtyre institucioneve në lidhje me standardet, politikat dhe procedurat e auditimit, ndërsa gjatë diskutimit të panelit rreth integritetit të elementeve të auditimit të IT-së në të gjitha fushat e auditimit, u shëmbyen ide dhe mendime mbi të ardhmen në auditimin IT.

Punimet e ditës së dytë, u zhvilluan në formatin e një seminari, ku u prezantua dhe u diskutua mbi progresin dhe zhvillimin e projekteve të Grupit të Punës së IT pranë EUROSAT-t ,kryesisht në menaxhimin e projekteve të zhvillimit të software-it.

Në këto punime, KLSH u paraqit me prezantimin mbi “CUBE & AITAM use case” (Përdorimi i Manualit Aktiv të Auditimit), i cili paraqiti benefitet e këtij mjeti në analizimin e riskut para fillimit të një auditimi. Gjatë punimeve u vijua edhe me prezantimet nga SAI i Polonisë dhe SAI i Portugalisë, të cilët paraqitën përpara audituesve pjesëmarrës, përmirësimet e këtij programi. Sipas tyre Aplikacioni mund të përdoret në web ose me dy paketa të njohura dhe gjerësisht të disponueshme të software-it, të mbështetur nga ekosistemet kryesore të desktop-it: MSOffice dhe LibreOffice. Të dhënat ruhen në formatin XML.

Gjatë qëndrimit në Bukuresht, përfaqësuesit e të gjithë SAI-ve, morën pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar me rastin e 30 Vjetorit të Gjykatës Rumune të Llogarive, në të cilën morën pjesë gjithashtu edhe disa figura të larta shtetërore të Rumanisë.